



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 26.6.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Srđan Mitrović, Liburn Aliu, Sali Zyba, Besa Gaxherri, Enver Hoti.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Editë Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.5.2018;
3. Konfirmimi për leximin e dytë të Projektligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike,
6. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 maj 2018**

**Kryetari i komisionit** konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 maj 2018.

**Para se të vazhdoi pika e tretë, Kryetari Daut Haradinaj** sugjeroj që kryesuesja e GP për draftimin e Ligjit për Rregullimin e shërbimeve të ujit të arsyetoi ndryshimet e fundit dhe ja dha fjalën. **Besa Gaxherri** potencoi se grupi punues shumë me sukses ka përfunduar draftimin e këtij Ligji i cili tani dërgohet në Kryesi dhe vazhdon pastaj në Qeveri për mendim, dhe shtoi se janë bërë disa ndryshime teknike në bashkëpunim me zyrtarët e ARRU por të rëndësishme për ligjin. **Kryetari** me votim unanim të pranishmëve konstatoi se drafti i Ligjit për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit përcjellet në Kryesi për të dërguar në Qeveri për mendim, i cili pasi kthehet nga Qeveria procedohet në procedurën e rregullt parlamentare si projektligj.

### **3. Konfirmimi për leximin e dytë të Projektligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje**

**Kryetari Daut Haradinaj** njoftoi komisionin se projektligji në fjalë ka kaluar edhe nëpër komisionet e përhershme të kuvendit, ndaj pyeti nëse nuk ka vërejtje shtesë nga deputetët, mund të procedohet në mbledhje plenare për miratim me 9 amendamente të komisionit dhe 19 amendamente të LS të pa përkrahura nga komisioni funksional.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz**

**Kryetari Daut Haradinaj** për projektligjin në fjalë konstatoi se komisioni ka përkrahur në pako bashkërisht me sugjerimet nga Qeveria dhe ka vendosur që komisioni të punoj këtë projektligj komplet pa u caktua grupi i veçantë punues, mirëpo potencoi se vërejtjet e qeverisë duhet të shndërrohen në amendamente poçes komisioni konsideron se janë të bazuara, ndaj edhe pse është urgjente ky ligj, sugjeroi që **Ganimete Musliu**, e cila mori përkrahjen e komisionit si kryesuese e grupit punues (komisionit), deri nesër të shqyrtoi këto vërejtje dhe të propozoi komisionit a ka nevojë të shndërrohen vërejtjet e Qeverisë në amendamente. Nesër grupi punues mblidhet në orën 13,00 për të shqyrtuar këtë projektligj.

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike**

**Kryetari Daut Haradinaj** në fillim falënderoi kryesuesin dhe grupin punues për punën që kanë kryer rreth projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike dhe ja dha fjalën kryesuesit **Andin Hoti** i cili konstatoi punën e frytshme në këtë grup punues bashkërisht me zyrtarët nga IHMK dhe ASHNA dhe filloi një nga një të lexoi propozim amendamentet për këtë projektligj :

#### **Amendamenti 1**

Neni 3, nënparagrafi 1.22, pas fjalës “**gjegjëse**” shtohet “**të ulët dhe**” dhe vazhdon teksti si në projektligj.

#### **Amendamenti 2**

Neni 3, pas nënparagrafit 1.22, shtohen 3 nënparagrafë të rinjë:

**1.23. Aerodrom** - do të thotë një zonë e caktuar mbi tokë ose ujë (duke përfshirë të gjitha ndërtesat, instalimet dhe pajisjet) të cilat përdoren plotësisht apo pjesërisht për arritjen, ngritjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionëve; termi “aerodrom” përfshin, por nuk kufizohet, të gjitha aeroportet, fushat ajrore dhe/ose fushat e planerimit.

**1.24. Hapësira ajrore e ulët** – nënkupton hapësirën nga sipërfaqja e tokës deri në nivelin e fluturimit FL205 (20500 feet ose 6248.4 m)

**1.25. Hapësira ajrore e lartë** - nënkupton hapësirën mbi nivelin e fluturimit FL205 (20500 feet ose 6248.4 m) e më lartë.

#### **Amendamenti 3**

Neni 3, nënparagrafin 1.28 dhe në tërë tekstin e projektligjit, emri “**Agjencioni i mbrojtjes së mjedisit të Kosovës**” zëvendësohet me “**Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës**”;

Neni 3, nënparagrafin 1.29, dhe në tërë tekstin e projektligjit, emri “**Agjencioni i menagjimit të emergjencave**” zëvendësohet me “**Agjencia e Menaxhimit Emergjent**”

#### **Amendamenti 4**

Neni 6, paragrafi 1 dhe Neni 30 paragrafi 1, pas shkurtesës “**MMPH**” fshihet “**/AMMK**” dhe vazhdon teksti si në projektligj.

#### **Amendamenti 5**

Neni 6, nënparagrafi 1.11, fshihet.

#### **Amendamenti 6**

Neni 7, paragrafi 1: riformulohet si në vijim:

**1. Shërbimet meteorologjike me interes për aviacionin e Republikës së Kosovës i kryen Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror (ASHNA) e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimet të Navigacionit Ajror dhe e certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC-ja) për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror brenda Republikës së Kosovës duke përfshirë edhe shërbimet meteorologjike aeronautike.**

#### **Amendamenti 7**

Neni 9, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

**2. Veprimtaritë e tjera meteorologjike dhe hidrologjike të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji përveç IHMK-së i kryejnë edhe personat juridik dhe fizik për nevojat e veta, me përjashtim të parashikimit dhe saktësimit të motit për Republikën e Kosovës. Parashikimi zyrtar i motit dhe paralajmërimi i hershëm i fatkeqësive të mundshme natyrore me origjinë hidrometeorologjike për Republikën e Kosovës jepet nga IHMK dhe janë ekskluzivitet i IHMK-së.**

#### **Amendamenti 8**

Neni 9, paragrafi 5, pjesa e fjalisë në fillim fshihet “Ministri i MMPH me propozim të” dhe vazhdon teksti i pandryshuar.

#### **Amendamenti 9**

Neni 9, paragrafi 10, riformulohet si në vijim:

**10. Në rastet e domosdoshme, aktivitetet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni, kryhen nga IHMK, për të cilat IHMK kërkon kompensim financiar (pagesë).**

#### **Amendamenti 10**

Neni 11, paragrafi 1, pas fjalës “tarifës” pjesa tjetër riformulohet si në vijim: “përcaktohet me Rregullore të veçantë.”

#### **Amendamenti 11**

Neni 11, paragrafi 2, në fund pas fjalës “Qeveria” pjesa tjetër fshihet.

#### **Amendamenti 12**

Neni 13, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

**2. IHMK, përmes mediave dhe web faqes së sajë, informon publikun mbi gjendjen e motit, klimës dhe ujit.**

#### **Amendamenti 13**

Neni 13, paragrafi 3, riformulohet si në vijim:

**3. IHMK lëshon njoftimet, lajmërimet dhe paralajmërimet mbi fatkeqësitë natyrore të katastrofave meteorologjike dhe hidrologjike, si dhe për rastet e tejkalimit të kufirit të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokave për lokacione të caktuara duke informuar institucionet relevante.**

#### **Amendamenti 14**

Neni 15, paragrafi 2, pas fjalës “hidrologjike” fshihet pjesa tjetër: “me përjashtim të stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit, në pajtim me këtë ligj”,

#### **Amendamenti 15**

Neni 15, paragrafi 3, riformulohet si në vijim:

**3. Rrjeti shtesë i stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit përcaktohet me Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.**

#### **Amendamenti 16**

Neni 15, paragrafi 6, pas fjalës “hidrologjike” fshihet pjesa e fjalisë “në përputhje me rregulloren e Nr.01/2015”.

#### **Amendamenti 17**

Neni 18, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

**1. IHMK mban regjistrin e stacioneve të rrjetit meteorologjike dhe hidrologjike si dhe rrjeteve të tjera të stacioneve meteorologjike dhe hidrologjike, në të cilin jepen informacionet standarde të stacioneve “metadatat” e stacioneve.**

#### **Amendamenti 18**

Neni 18, paragrafi 3, fshihet.

#### **Amendamenti 19**

Neni 25, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

**1. Të dhënat dhe informacioni mbi motin, klimën, gjendjen e ujit dhe cilësinë e ajrit, ujit, dhe tokës, të siguruar nga IHMK me anë të sistemit shtetëror të stacioneve meteorologjike, hidrologjike dhe stacioneve monitoruese të ajrit dhe ujit, do të jenë publike në formë të raporteve/buletineve periodike dhe vjetarëve, si dhe në formë të informimit në kohë reale për stacionet që janë të paisuar me transfer automatik të të dhënave.**

#### **Amendamenti 20**

Neni 25, paragrafi 2 fshihet.

#### **Amendamenti 21**

Neni 28, paragrafi 3, në fund pas fjalës “adekuate” shtohet: “përveç informatave që janë me interes për publikun”

#### **Amendamenti 22**

Neni 28, paragrafi 5 fshihet:

#### **Amendamenti 23**

Neni 29, paragrafi 1, bëhet emërtimi i saktë i direktivës “Direktivën e Bashkimit Evropian 2007/02 BE të Parlamentit Evropian të dt. 14.03.2007, që përcakton Infrastrukturën e Informacionit Hapësinor në Komunitetin Evropian- (INSPIRE). “

#### **Amendamenti 24**

Neni 34, paragrafi 2, numri “8” zëvendësohet me numrin “7”.

#### **Amendamenti 25**

Neni 38, “Ligji Nr. 02/L-79/2006 për Veprimtarin Hidrometeorologjikë” zëvendësohet me “Ligji nr. 02/L-79 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike.

Pasi që u miratua riformulimi i **Nenit 18**, propozim amendamentet aritën numrin 25 të cilat edhe u miratuan nga Komisioni me një abstenim (abstenimi nga anëtari i komisionit Srdjan Mitrovic). Projektligji gjithashtu do të përmirësohet mundësisht pa amendamente sa i përket gabimeve drejtshkrimore gjuhësore dhe me amendamente i dërgohet Komisioneve të përhershme.

#### 4. Te ndryshme

**Kryetari Daut Haradinaj** konstatoi se janë disa kërkesa të anëtarëve të komisionit si vijon :

- **Andin Hoti** kërkoi të ftohet Ministri i Bujqësisë në komision rreth mundësisë së debatimit për dëmet shumë të mëdha nga rreshjet e fundit në Rahovec dhe rrethinë, gjithashtu edhe **Ganimete Musliu** arsyetoi këtë kërkesë ngase komisioni duhet të ketë njohuri çka vepron në këtë ministri, ngase siç ceku ajo “nëse nuk kemi çasje në këtë ministri atëherë më mirë po heqim dorë nga mbikëqyrja parlamentare”,
- **Salih Salihu** kishte propozim për një vizitë në IHMK ngase ky institut hidrometeorologjik nuk mjafton të mbështetet nga komisioni vetëm me miratim të projektligjit të sotëm por të mbështetet në secilin veprimtari të institutit në fjalë të cilat janë shumë të rëndësishme për bujqësinë e Kosovës,
- **Besa Gaxherri** potencoi rëndësinë e vizitave të jashtme të komisionit, sidomos me komisionet homologe në Shqipëri, Maqedoni dhe Malin e Zi e Serbi,
- **Kryetari Daut Haradinaj** përkrahu iniciimet e deputetëve duke sugjeruar që fillimisht vizita në IHMK dhe në Rahovec të bëhet brenda një dite, kurse Ministri i Bujqësisë do të ftohet në Komision të hënën ose të martën e javës që vjen. Sa i përket vizitave tek komisionet homologe jashtë vendit, kryetari qysh nga sot i inicioi ato duke u angazhuar përmes ambasadave në Kosovë dhe për çka komisioni do të njoftohet.
- Në të ndryshme nesër komisioni do të deklarohet edhe për dy pika tjera (një ankesë dhe një iniciim).

Mbledhja përfundoi në orën 14,15.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

Kryetari i Komisionit,  
**Daut Haradinaj**